



**Shumë të nderuarit Imam
Muhamed Sytari, Myftiu i Shkodrës,**

Vëllezërve dhe motrave Myslimanë,

Në emërin tim personal dhe në emër të Arqidioqezës Shkodër-Pult ju uroj: **GËZUAR festën e 'ID AL-FITR-it, Bajramit.**


Festa e Bajramit vjen pas agjerimit dhe lutjes që bëtë gjatë muajit të Ramazanit, i cili është i rëndësishëm për jetën e bashkësisë myslimane dhe që uroj t'i ketë dhënë secilit një forcë të re në jetën shpirtërore personale, shoqërore dhe familjare, në këtë kohë të vështirë.

Këshilli Papnor për Dialogun Ndërfetar ju shpreh të gjithëve ju urimet e tij më të mira me uratë dhe me përgëzime të përzemërta dhe sivjet Mesazhi e Tij ka si motoja: **“Të krishterë dhe myslimanë: bashkendajne gëzimet dhe hidhërimet”**:

“Të gjithë ne bashkëndajmë dhuratat e Zotit: ajrin, ujin, jetën, ushqimin, frytet e perparimit në fushën mjeksore dhe farmaceutike, rezultatet e perparimit shkencor dhe teknologjik në fusha të ndryshme... Vetëdija për mirësinë dhe bujarinë e Zotit na mbush zemrat me mirënjohje nda Tij dhe, në të njejtin kohë na inkurajonë t'i bashkëndajmë dhuratat e tij me vëllezërit dhe motrat tona që gjenden në çdo lloj nevojë”

Zoti i Mëshirshëm dhe i Gjithëpushtetshëm na ndihmoftë që të ecim gjithmonë në rrugën e mirësisë, të dhembshurisë dhe të paqes në Ukrainën e në të gjithë botën.

PËRSHUMËVJET BAJRAMIN



† Angelo Massafra O.F.M.

Arqipeshkëv Metropolit Shkodër-Pult
President i Konferencës Ipeshkvnore Shqiptare